

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Have Haliti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sadik Kryeziu, procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit J.M., për shkak të veprës penale- falsifikim i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit J.M., av.B.S., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.189/15 të datës 15.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.10.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.189/15 i datës 15.03.2018 vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.189/15 të dt. 15.03.2018 i akuzuari J.M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale- falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPRK-së dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit, i është zëvendësuar me dënim me gjobë në lartësi prej 5.000 (pesëmijë)€. Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 31.03.2015 deri me datën 31.08.2015. Në rast se pjesa e mbetur e dënimit me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera të parapara me nenin 46 par.3 të KPRK-së, dënimi i caktuar më gjobë do të shndërrohet në dënim burgu, ashtu që për cdo 20 euro të akuzuarit do të llogartet një ditë burgu.

Konform nenit 302 par.6 të KPRK-së, paratë e falsifikuara në shumën prej 34.500.00 (tridhjetë e katër mijë e pesëqind) dollarë amerikan, janë konfiskuar në mënyrë të përhershme.

Është obliguar i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi këtë ankesë, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me burgim efektiv.

-Përgjigje në ankesën e prokurorit ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit J.M., av. B.S., i cili ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e prokurorit, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/I nr.471/18 të dt. 12.10.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ashtu që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burg efektiv, kurse përgjigja në ankesë e mbrojtësi të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, për shkak se kemi të bëjmë me aktgjykimin e ankimuar në të cilin i akuzuari është dënuar me dënim me gjobë, gjykata nuk e ka parë të arsyeshme që të mbahet seancë gjyqësore, e për këtë palët nuk janë njoftuar për seancën e kolegjit.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të Prokurorit dhe përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që nuk lejohet ankesa për këtë bazë ankimore sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe me këtë është pajtuar prokurori si dhe trupi gjykues, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve tjera ankimore.

Vendimi mbi dënimin

Duke shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit, konstaton se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqiptimit të dënimin kundër të akuzuarit nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë adekuat me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, ashtu që të akuzuarit i ka shqiptuar dënim jo proporcional me

peshën e veprës së kryer. Prokurori në ankesë tutje thekson se gjykata e shkallës së parë, ka marrë gabimisht si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë dh si rrethana lehtësuese pendimin e shprehur dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale të tilla ose të ngjashme dhe gjendjen shëndetësore të tij, mirëpo sipas prokurorit pranimi i fajësisë nuk mund të merret si rrethanë veçanërisht lehtësuese , pasi që e njëjta është paraparë me dispozitat e nenit 74 par.3 nën par 3.10 të KPRK-së si rrethanë lehtësuese e jo si rrethanë veçanërisht lehtësuese.

Prokurori po ashtu pretendon se gjykata e shkallës së parë vetëm i ka cekur rrethanat lehtësuese duke mos dhënë asnjë arsytim konkret se përse e konsideron atë rrethanë veçanërisht lehtësuese, e po ashtu në arsytim të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethanë veçanërisht rënduese , mirëpo nuk ka marrë parasysh si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri i ka hedh paratë dhe nuk është ndaluar në urdhrat e policisë, si dhe shkallën e lartë të dashjes se personit për të vënë në qarkullim paranë e falsifikuar, duke shtuar më tutje se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit nuk do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 par.1.1 dhe 1.2, e posaçërisht nuk do të parandalohet kryesi nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe nuk do të bëhet rehabilitimi i tij.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, që ndikojnë në ashpërsimin ose zbutjen e dënimit. Si rrethanë posaçërisht lehtësuese e morri parasysh faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer, kurse si rrethanë lehtësuese morri pendimin e shprehur për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme si dhe gjendjen shëndetësore të tij, kurse në mungesë të rrethanave veçanërisht rënduese, gjykata ka marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale. Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit. Me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata merr parasysh mirëpo nuk kufizohet në rrethanat rënduese apo lehtësuese të cilat ndikojnë në shqiptim të dënimit, ku sipas dispozitës së nenit 75 par.1 nën par.1.3, gjykata mund të shqiptojë dënim edhe nën kufirin e paraparë me ligj në rastet kur kryesi e pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë, gjykata udhëzohet mirëpo nuk detyrohet nga kufizimet e parapara me nenin 76 të KPK-së sepse dënimi mund të zbutet edhe jashtë kriterëve të parapara me këtë nen, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale dhe është në funksion të preventivës së përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura si më lartë ankesa u refuzua si e pa bazuar.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 495/2018 datë 16.10.2018

Procesmbajtës,

Sadik Kryeziu

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro